

03.07.2026

Procesverbal - Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i procedurës: “Marrje me qera PDA per faturuesit me karte SIM”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Aparate kontrolluese 38500000-0

Vlera e fondit limit: 24.933.000 (njezer e kater milion e nenteqind e tridhjetë e tre mijë) lekë pa tvsh.

Vlera e fondit Limit ne monedhen nderkombetare Euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte **265.047,3** (dyqind e gjashtedhjetë e pesë mijë e dyzet e shtatë presje tre) euro.

Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes te Shqiperise datë 03.07.2026 është 94.07.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor UKT sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10

b.Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3 ;përkatësisht në Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është 499.860 (katerqind e nentedhjetë e nente mijë e teteqind e gjashtedhjetë) leke.

Shuma e kerkuar e sigurimit te ofertes ne monedhen nderkombetare Euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte 5.313,7 (pesë mijë e treqind e trembedhjetë presje shtatë) euro.

Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes te Shqiperise datë 03.07.2026 është 94.07 euro.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2 Kapaciteti ekonomiko-financiar

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Nenin 43, pika 1, pika 2 b), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 , pika 1 , pika 2 , si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise”, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike".

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe nenin 19, pika 2, të VKM Nr. 498, datë 1.8.2024 për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të këshillit të ministrave, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK”, të ndryshuar

2.2.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2026 të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006) “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar;

(lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2026).

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2026 sipas kësteve të parashikuara në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 si dhe vendimeve respektive të Këshillave Bashkiakë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2026 sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet të kryera gjatë tri viteve të fundit (përllogaritur nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës)

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara

sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e kryera,

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e kryera

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001 **(ose ekuivalente)** (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).
- b) Operatori Ekonomik duhet të disponojë Çertifikatën ISO 27001 **(ose ekuivalente)**, e vlefshme, mbi “Sistemet menaxhimit të sigurisë së informacionit”. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimit të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

ISO/IEC 27001 është standardi ndërkombëtar për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (Information Security Management System – ISMS).

Ai parashikon që organizata të krijojë, zbatojë, mirëmbajë dhe përmirësojë vazhdimisht një sistem për menaxhimin e sigurisë së informacionit, me qëllim mbrojtjen e të dhënave nga rreziqet e ndryshme.

Në mënyrë më konkrete, ISO/IEC 27001 parashikon:

- Identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve që cenojnë sigurinë e informacionit.
- Vendosjen e masave të kontrollit për mbrojtjen e të dhënave dhe sistemeve.
- Garantimin e **konfidencialitetit (Confidentiality)**, në mënyrë që informacioni të aksesohet vetëm nga persona të autorizuar.
- Garantimin e **integritetit (Integrity)**, duke siguruar që të dhënat të mos ndryshohen ose dëmtohen në mënyrë të paautorizuar.
- Garantimin e **disponueshmërisë (Availability)**, që informacioni dhe sistemet të jenë të aksesueshme kur nevojiten.
- Menaxhimin e incidenteve të sigurisë së informacionit.
- Kontrollin e aksesit në sisteme dhe pajisje.
- Mbrojtjen e rrjeteve dhe komunikimeve elektronike.
- Politika për kopje rezervë (backup), rikuperim të të dhënave dhe vazhdimësi të biznesit.
- Trajnimin dhe ndërgjegjësimin e personelit për sigurinë e informacionit.
- Auditimin periodik dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të sigurisë.

Në rastin e procedurës "Marrje me qera PDA për faturuesit me kartë SIM", kjo ISO është e rëndësishme sepse pajisjet PDA:

- përpunojnë të dhëna të abonentëve;
- transmetojnë të dhëna përmes rrjetit celular;

- lidhen me sistemin e faturimit të Autoritetit Kontraktor;
- duhet të mbrohen nga akseset e paautorizuara, humbja ose manipulimi i informacionit.

Prandaj, kërkitimi i ISO/IEC 27001 siguron që operatori ekonomik disponon një sistem të certifikuar për menaxhimin e sigurisë së informacionit, duke reduktuar rreziqet që lidhen me përpunimin, ruajtjen dhe transmetimin e të dhënave gjatë ekzekutimit të kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për mallrat e kërkuara. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit duhet të vertetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, uebfaqe, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020, nenin 73 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Njësia e Prokurimit gjykon se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në përputhje dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi.

Pra nëpërmjet vendosjes së kriterit të sipërpërmendur AK garantohet dhe fiton siguri se operatori ekonomik kontraktues do të furnizojë dhe do të përmbushë kontratën me sukses.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, lidhur me produktet PDA dhe UK Reader të gatshëm duhet të paraqesë Materiale teknike të prodhuesit (katalog teknik për produktet PDA të ofruara si dhe Sistemi i leximeve);

Gjithashtu App mobile i sistemit të leximeve duhet të jetë i certifikuar nga të paktën një prodhues pajisjesh mobile PDA. Në certifikatë të konfirmohet që App mobile i zgjidhjes së ofruar është i përfshirë për PDA të atij prodhuesi. Certifikata të jetë lëshuar brenda 3 viteve të fundit nga data e shpalljes së kësaj procedure.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pikën 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Vendosja e kriterit të sipërcituar është vënë në mbështetje të nenit 40 pika 6 gërma b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar parashikohet shprehimisht....

Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) fotografitë apo katalogjet teknike

Paraqitja e katalogëve të prodhuesve është e nevojshme në funksion të verifikimit të përpuethshmërisë së produkteve me specifikimet teknike të AK me qëllim realizimin e kontratës me sukses.

Argumentim Teknik Kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë materiale teknike të prodhuesit (katalog teknik për pajisjet PDA të ofruara dhe për sistemin e leximeve), si dhe certifikimin e aplikacionit (App Mobile) nga të paktën një prodhues i pajisjeve PDA, është vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", pasi lidhet drejtpërdrejt me natyrën, funksionalitetin dhe performancën e objektit të kontratës.

Paraqitja e katalogëve teknikë të prodhuesit është e nevojshme për t’i mundësuar Autoritetit Kontraktor verifikimin objektiv të karakteristikave teknike të pajisjeve PDA dhe të sistemit të leximeve, duke garantuar që produktet e ofruara përmbushin specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përshtatshme për përdorimin e përditshëm në procesin e leximit dhe faturimit në terren.

Për shkak se pajisjet PDA do të përdoren për mbledhjen, përpunimin dhe transmetimin në kohë reale të të dhënave të konsumit të abonentëve, është thelbësore që aplikacioni (App Mobile) të jetë plotësisht i përputhshëm me pajisjen në të cilën do të instalohet dhe do të operojë.

Për këtë arsye, kërkohet që aplikacioni të jetë i certifikuar nga të paktën një prodhues i pajisjeve PDA, ku të konfirmohet se aplikacioni është testuar dhe është i përshtatshëm për funksionimin në pajisjet e atij prodhuesi. Ky certifikim garanton përputhshmërinë (compatibility), stabilitetin operacional dhe funksionimin korrekt të aplikacionit me komponentët hardware të pajisjes, duke reduktuar rrezikun e mosfunksionimit, ndërprerjeve të shërbimit, humbjes së të dhënave apo problemeve të performancës gjatë ekzekutimit të kontratës.

Kërkesa që certifikata të jetë lëshuar brenda tre viteve të fundit siguron që certifikimi i referohet versioneve aktuale të aplikacionit dhe pajisjeve PDA, duke marrë në konsideratë zhvillimet e vazhdueshme teknologjike, përditësimet e sistemeve operative dhe ndryshimet në platformat hardware. Në këtë mënyrë, Autoriteti Kontraktor sigurohet se zgjidhja e ofruar është aktuale, e mbështetur nga prodhuesi dhe e përshtatshme për përdorim gjatë periudhës së ekzekutimit të kontratës.

Ky kriter është proporcional me objektin e prokurimit, lidhet drejtpërdrejt me cilësinë dhe besueshmërinë e zgjidhjes teknologjike që do të përdoret nga faturuesit në terren dhe synon të garantojë një sistem të qëndrueshëm, të testuar dhe plotësisht funksional gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

2.3.5 .Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë të garancisë të mallit të ofruar sipas përcaktimeve në shtojcën e specifikimeve teknike.

Argumentim: *Kërkesa që operatori ekonomik ofertues të paraqesë deklaratë të garancisë për mallin e ofruar, sipas përcaktimeve të parashikuara në specifikimet teknike, është vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", pasi lidhet drejtpërdrejt me garantimin e cilësisë, funksionalitetit dhe vijueshmërisë së shërbimit gjatë periudhës së ekzekutimit të kontratës.*

Objekti i kësaj procedure konsiston në marrjen me qira të pajisjeve PDA me kartë SIM, të cilat do të përdoren çdo ditë nga faturuesit e Autoritetit Kontraktor për leximin e matësave, regjistrimin dhe transmetimin në kohë reale të të dhënave të konsumit. Për shkak të përdorimit të vazhdueshëm në terren dhe rëndësisë që këto pajisje kanë për procesin e faturimit, është e domosdoshme që Autoriteti Kontraktor të ketë garanci se pajisjet do të funksionojnë sipas parametrave teknike të kërkuar gjatë gjithë periudhës së përdorimit.

Deklarata e garancisë përbën angazhimin formal të operatorit ekonomik për riparimin, zëvendësimin ose eliminimin e defekteve që mund të shfaqen gjatë periudhës së garancisë, pa kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor, në përputhje me kushtet e përcaktuara në specifikimet teknike.

Kjo kërkesë synon të minimizojë rrezikun e ndërprerjes së procesit të leximit dhe faturimit, të sigurojë vazhdimësinë e shërbimit, të mbrojë investimin publik dhe të garantojë që operatori ekonomik mban përgjegjësi për cilësinë dhe performancën e pajisjeve të ofruara.

Kriteri është proporcional me objektin e kontratës, nuk kufizon konkurrencën dhe i shërben interesit të Autoritetit Kontraktor për të garantuar furnizimin me pajisje funksionale, të besueshme dhe të mbuluara me garanci gjatë gjithë periudhës së përdorimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi i Specifikimeve Teknike

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me natyrën, kompleksitetin dhe funksionalitetin e shërbimit që synon të kontraktohet, me objekt "**Marrje me qera PDA për faturuesit me kartë**

SIM", me qëllim garantimin e një sistemi të qëndrueshëm, të sigurt dhe efikas për procesin e leximit të matësve në terren nga faturuesit e UKT sh.a.

Hartimi i këtyre specifikimeve është bërë në zbatim të nenit 36 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, duke respektuar parimet e konkurrencës, proporcionalitetit, mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Objekti i kontratës nuk konsiston vetëm në furnizimin me pajisje PDA, por në ofrimin e një zgjidhjeje të plotë teknologjike, e cila përfshin pajisjet mobile, licencat software, komunikimin përmes kartave SIM me APN të dedikuar, si dhe integrimin me sistemin ekzistues të faturimit të UKT sh.a., duke mundësuar administrimin në kohë reale të procesit të leximit të matësve.

Për këtë arsye janë përcaktuar kërkesa funksionale dhe teknike që garantojnë përputhshmërinë me infrastrukturën ekzistuese të Autoritetit Kontraktor, sigurinë e të dhënave, vazhdimësinë e shërbimit dhe eliminimin e ndërprerjeve gjatë procesit të leximeve.

Kërkesa që aplikacioni të funksionojë në sistemin operativ Android 14 ose më të ri është vendosur për të garantuar përputhshmëri me versionet më të fundit të sistemit operativ, mbështetje afatgjatë nga prodhuesit, nivel më të lartë sigurie, performancë më të mirë dhe jetëgjatësi të pajisjeve gjatë periudhës së përdorimit.

Specifikimet që lidhen me memorien RAM, hapësirën e ruajtjes, procesorin, baterinë, ekranin dhe karakteristikat e komunikimit janë përcaktuar për të siguruar funksionimin normal të aplikacionit të leximeve, përpunimin e një sasive të konsiderueshme të dhënash, ruajtjen e fotografive, koordinatave GPS dhe sinkronizimin e vazhdueshëm me serverin qendror pa ulur performancën e pajisjes.

Kërkesa për rezistencë minimale IP68/IP69K është vendosur duke marrë në konsideratë kushtet reale të punës së faturuesve në terren, të cilët operojnë në ambiente të hapura, në prani të lagështirës, pluhurit dhe kushteve atmosferike të ndryshme. Kjo kërkesë synon të minimizojë dëmtimet e pajisjeve dhe ndërprerjet e shërbimit.

Po kështu, bateria me kapacitet të lartë është kërkuar për të garantuar funksionimin e pandërprerë gjatë gjithë ditës së punës, duke qenë se pajisjet përdorin njëkohësisht GPS, internet celular, kamerë dhe aplikacionin e leximeve.

Kërkesa për përdorimin e APN privat dhe kartave SIM me trafik të dedikuar është argumentuar nga nevoja për të garantuar komunikim të sigurt ndërmjet pajisjeve PDA dhe serverit qendror, duke kufizuar aksesin nga rrjete të jashtme, duke rritur nivelin e sigurisë së transmetimit të të dhënave dhe duke mundësuar sinkronizimin në kohë reale të leximeve, fotografive dhe koordinatave gjeografike.

Specifikimet funksionale të aplikacionit janë hartuar për të siguruar administrimin e plotë të procesit të leximeve, planifikimin e itinerareve të faturuesve, regjistrimin e anomalive, dokumentimin me fotografi, gjurmueshmërinë e çdo veprimi të kryer nga përdoruesit, ruajtjen e historikut të ndryshimeve (audit trail), si dhe monitorimin në kohë reale të aktivitetit në terren.

Kërkesat mbi autentifikimin e përdoruesve, lidhjen e pajisjeve me IMEI, menaxhimin e roleve, enkriptimin e të dhënave, kontrollin e aksesit dhe ruajtjen e log-eve janë vendosur për të garantuar integritetin, konfidencialitetin dhe gjurmueshmërinë e informacionit që administrohet nga sistemi.

Komunikimi ndërmjet aplikacionit dhe sistemit qendror është kërkuar të realizohet nëpërmjet standardeve SOAP dhe/ose REST, pasi këto përbëjnë standarde ndërkombëtare të ndërveprueshmërisë ndërmjet sistemeve software dhe sigurojnë integrim të qëndrueshëm me sistemin ekzistues të faturimit.

Kërkesa që aplikacioni të mund të funksionojë edhe në mungesë të përkohshme të sinjalit celular, duke realizuar sinkronizimin automatik sapo të rikthehet lidhja me internetin, është vendosur për të garantuar vazhdimësinë e punës në çdo zonë të territorit ku operojnë faturuesit.

Gjithashtu, kërkesa që sistemi të jetë plotësisht në gjuhën shqipe dhe të shoqërohet me manual përdorimi dhe dokumentacion teknik në gjuhën shqipe synon të lehtësojë përdorimin nga stafi i Autoritetit Kontraktor dhe të garantojë administrimin korrekt të sistemit gjatë gjithë periudhës së kontratës.

Specifikimet teknike janë hartuar duke përcaktuar kërkesa minimale funksionale dhe teknike, pa favorizuar ndonjë prodhues, markë apo model të caktuar. Çdo referencë eventuale ndaj një teknologjie ose komponenti teknik konsiderohet e pranueshme edhe nëpërmjet zgjidhjeve ekuivalente, për sa kohë që ato garantojnë të njëjtin nivel funksionaliteti, sigurie dhe performance.

Në përfundim, Autoriteti Kontraktor vlerëson se specifikimet teknike të hartuara janë objektive, proporcionale me nevojën konkrete të kontratës dhe të domosdoshme për realizimin me sukses të procesit të leximit elektronik të matësve, administrimin në kohë reale të të dhënave dhe garantimin e vazhdimësisë së shërbimit, duke respektuar njëkohësisht parimet e konkurrencës së lirë dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë

Njësia e prokurimit